

Fleta e të dhënave të produktit
Botimi 03/05/2017
Kodi: 03.02.070
Nr. i identifikimit: 010701010020000043
Sikalastic®-152



EN 1504-2:2004

EN 14891:2012/AC:2012

13

0546

01599

Sikalastic®-152

Llaç çimentoje me 2 përbërës dhe tharje të shpejtë për hidroizolim fleksibël dhe mbrojtje betoni

Përshkrimi i produktit

Sikalastic®-152 është llaç me dy përbërës i përforcuar me fibra, me modul shumë të ulët elasticiteti, bazë çimentoje të modifikuar me polimere të posaçme rezistente ndaj alkaleve, me përmbajtje agregatesh të përzgjedhura me kokrriza të imëta dhe aditivë të mjaftueshëm për hidroizolim dhe mbrojtjen e nënshtresave prej betoni që janë subjekt i shformimit nga përkulja. Sikalastic®-152 këshillohet veçanërisht për aplikime në mjedise me prani lagështie ose në kushte me temperatura të ulëta.

Përdorime

- Hidroizolim dhe mbrojtje e strukturave hidraulike si basene, rezervuarë, pishina, tubacione betoni, ura dhe kanale
- Hidroizolim dhe mbrojtje e mureve të jashtëm që do të mbulohen me dhe
- Hidroizolim i brendshëm nën presion hidrostatik negativ të ulët muresh dhe dyshemesh në bodrume
- Hidroizolim i tarracave dhe ballkoneve me nënshtresa betoni ose pllakash të vjetra
- Hidroizolim i sipërfaqeve të ekspozuara ndaj kushteve të motit
- Veshje mbrojtëse, fleksibël, kundër karbonimit e sipërfaqeve prej betoni të dëmtuara gjithashtu nga tkurrja plastike dhe hidraulike
- Veshje fleksibël për strukturat prej betoni, janë gjithashtu subjekt i shformimit nga përkulja
- Mbrojtje e sipërfaqes prej betoni, në përputhje me parimet e mëposhtme të EN 1504-9: 1: mbrojtje kundër depërtimeve (veshje); 2: kontroll i lagështisë (veshje); 8: shtim i rezistencës (veshje)

Karakteristika / Avantazhe

- Hidroizolim fleksibël dhe mbrojtje betoni në një produkt
- Aplikim i besueshëm edhe në mjedis me shumë lagështi
- I aplikueshëm edhe mbi nënshtresa me pak lagështi
- Nuk varet: aplikim i lehtë edhe mbi mure vertikale
- Tharje e shpejtë (edhe në temperaturë të ulët)
- Vetë ngushtimi të plasaritjeve
- Ngjitje e shkëlqyer mbi pothuajse të gjitha nënshtresat, si p.sh betoni, llaçet e çimentos, qeramikat, tullat dhe druri
- Rezistencë e lartë ndaj kripërave për shkrirje akulli dhe dioksidit të karbonit

Construction



Testime

Miratime / Standarde	<p>Llaç me bazë çimentoje i përforcuar me fibra dhe me dy përbërës për hidroizolim dhe mbrojtje të betonit sipas EN 1504-2, Parimet 1, 2 dhe 8 (Metodat 1.3, 2.2, 8.2 të EN 1504-9)</p> <p>Llaç çimentoje me 2 përbërës për hidroizolim nën pllakat e ngjitura (të ngjitura me kollë C2 sipas EN 12004) me aftësi të përmirësuar për ngushtimin e plasaritjeve në temperaturë të ulët (-20°C) dhe rezistencë ndaj kontaktit me ujin e kloruar, në pajtueshmëri me performancën e kategorisë CMO2P të EN 14891:2012.</p> <p>DoP 020701010020000043 1026, certifikuar nga Organi i Kontrollit të Prodhimit në Fabrikë 0546 dhe nga laborator i njoftuar 01599 dhe mbart shenjën CE.</p>
-----------------------------	---

Të dhënat e produktit

Paraqitja/Ngjyra	gri
Ambalazhi	Ambalazh 33 kg: Përb. A (lëng): 8 kg Përb. B (pluhur): 25 kg

Magazinimi

Kushtet e magazinimit / Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit, nëse magazinohet saktë në ambalazhin origjinal të mbyllur dhe të padëmtuar, në kushtë të thata dhe të freskëta.
---	---

Të dhënat teknike

Baza kimike	Çimento e modifikuar me polimere, agregate të përzgjedhura, mikrosilic dhe fibra.
Dendësia	~ 1.8 kg/l
Granulometria	D_{max} : 0.5 mm (EN 12192-1)

Kërkesat sipas EN 1504-2

	Metoda e testimit	Rezultatet	Kërkesat
Përshkueshmëria e CO₂	EN 1062-6	$S_D > 50$	$S_D \geq 50$ m
Përshkueshmëria e avujve të ujit	EN ISO 7783	$S_D \sim 1.00$ (Class I)	Kategoria I $S_D < 5$ m (i përshkueshëm) Kategoria II $5\text{m} < S_D < 50\text{m}$ Kategoria III $S_D > 50\text{m}$ (i papërshkueshëm)
Absorbueshmëria kapilare dhe përshkueshmëria e lëngjeve-ujit	EN 1062-3	$\sim 0,005 \text{ kg m}^{-2} \text{ h}^{-0.5}$	$w < 0,1 \text{ kg m}^{-2} \text{ h}^{-0.5}$
Cikli ngrirje- shkrirje (zhytje në kripë akullshkrirëse)	EN 13687-1	$\sim 1.30 \text{ MPa}$	$\geq 0.8 \text{ MPa}$
Forca e ngjitjes	EN 1542	$\sim 1.50 \text{ MPa}$	$\geq 0.8 \text{ MPa}$
Ngushtimi i plasaritjeve	EN 1062-7	$\sim 1.25 \text{ MPa}$	Kategoria A3 (+23°C)
Substanca të rrezikshme (Chromium VI)	EN 196-10	$< 0.0002\%$	$< 0.0002\%$
Reagimi ndaj zjarrit	EN 13501-1	A2	Euroclass

Kërkesat sipas EN 14891:2012

	Metoda e testimit	Rezultatet	Kërkesat
Hidroizolimi (1.5 bar për 7 ditë)	A.7	Pa depërtim	Pa depërtim

Rezistenca fillestare e ndërkapjes ndaj tërheqjes	A.6.2	~ 1.0 MPa	≥ 0.5 MPa
Rezistenca e ndërkapjes ndaj tërheqjes pas kontaktit me ujin	A.6.3	~ 0.7 MPa	≥ 0.5 MPa
Rezistenca e ndërkapjes ndaj tërheqjes pas vjetrimin me nxehtësi	A.6.5	~ 1.8 MPa	≥ 0.5 MPa
Rezistenca e ndërkapjes ndaj tërheqjes pas cikleve ngrirje shkrirje	A.6.6	~ 0.6 MPa	≥ 0.5 MPa
Rezistenca e ndërkapjes ndaj tërheqjes pas kontaktit me ujë gëlqereje	A.6.9	~ 0.7 MPa	≥ 0.5 MPa
Rezistenca e ndërkapjes ndaj tërheqjes pas kontaktit me ujë të kloruar	A.6.7	~ 0.9 MPa	≥ 0.5 MPa
Aftësi për ngushtim plasaritjesh, kushte normale (+23°C)	A.8.2	≥ 0.75 MPa	≥ 0.75 MPa
Aftësia për ngushtim plasaritjesh në temperatura të ulëta (-20°C)	A.8.3	≥ 0.75 MPa	≥ 0.75 MPa

Vlerat e dhëna me konsumim total prej 5.4 kg/m² në dy shtresa

Informacione mbi sistemin

Detaje aplikimi

Konsumimi/ Doza	Për udhëzim: ~1.8 kg/m ² /mm
Cilësia e nënshtresës	Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme dhe të jetë pa pluhur, pislëqe, materiale të lira, kontaminues sipërfaqësorë si vaji apo graso, kore çimentoje.
Përgatitja e nënshtresës	<p>Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si uji me presion të lartë (400 bar) ose përpunim me rrymë rëre, rrymë uji për të hequr të gjitha veshjet e mëparshme, fërkim me furçë teli. Smerilizoni dhe bluani pllakat qeramike ekzistuese, etj. për të hequr shtresat dhe bojrat, grason, ndryshkun, disarmantët, koren e çimentos dhe produkte të tjera që mund të reduktojnë ndërkapjen. Pluhuri duhet larguar me fshesë thithëse elektrike. Nëse nevojitet, riparoni betonin e dëmtuar, shpetëzuar ose të dobët me llaçet Sika MonoTop[®], SikaTop[®], SikaRep[®].</p> <p>Lëmoni të gjitha qoshtet apo profilet e mprehta (kryqëzime dyshemeje dhe muri, etj.) duke i dhënë formë të lakuar, me përdorimin e llaçeve Sika MonoTop[®], për të përmirësuar efikasitetin e aplikimit.</p> <p>Nënshtresa duhet lënë e thatë ose e lagësht, pra siç është. Mos e lagni përpara aplikimit. Shmangni mbledhjen e ujit mbi sipërfaqe apo kondensimin gjatë aplikimit.</p> <p>Fugat e betonit, depërtimet e tubacioneve dhe të gjitha llojet e pavazhdimësive në konstrukcion duhet të mbyllen dhe hidroizolohen duke përdorur sistemin Sikadur[®] Combiflex[®] SG ose produkte nga seria SikaSwell[®] apo produkte të tjera të përshtatshme.</p>

Kushtet e aplikimit / Kufizime

Temperatura e nënshtresës	+5 °C min. / +35 °C max.
Temperatura e ambientit	+5 °C min. / +35 °C max.

Udhëzime aplikimi

Raporti i përzierjes

Përb. A : Përb. B = 8 : 25

Përzierja

Sikalastic®-152 mund të përzihet me një përzierës elektik me shpejtësi të ulët (~ 500 r.p.m.).
Tundeni me kujdes Përb. A përpara përdorimit. Pastaj hidhni ~ ½ Përb. A në një konteiner të përshtatshëm për përzierje dhe shtoni ngadalë Përb. B ndërsa jeni duke përzierë. Kur të jetë homogjene, shtoni sasinë e mbetur të Përb. A dhe përzieni plotësisht për të paktën 3-4 minuta, derisa të arrihet konsistenca e duhur pa kokrriza.

Mos hidhni ujë shtesë apo përbërës të tjerë, çdo njësi paketimi duhet përzierë e gjitha, për të shmangur shpërndarjen e gabuar të agregateve që përmban përbërësi në formë pluhuri.

Metoda e aplikimit / Mjetet

Aplikimi me mallë:

Aplikoni Sikalastic®-152 me mallë duke ushtruar presion të madh mbi nënshtresë.

Aplikoni shtresën e parë të Sikalastic®-152 me një mallë të dhembëzuar (3x3 mm), me presion të fortë mbi nënshtresë për të arritur një trashësi të rregullt dhe konsistente. Sapo të jetë ngurtësuar shtresa e parë, aplikoni shtresën e dytë të Sikalastic®-152 me mallë, duke u kujdesur për të arritur një shtresë të vazhdueshme dhe të njëtrajtshme, e cila mbulon plotësisht të parën.

Trashësia totale maksimale e rekomanduar për produktin është të paktën 3 mm, minimalisht në 2 shtresa. Trashësia maksimale e rekomanduar për shtresë është 2 mm për aplikim manual ose me spërkatje.

Në zona me sforcim të lartë, duhet të vendoset një pëlhurë e posaçme me fibra qelqi rezistente ndaj alkaleve (150-160 gr/m² dhe 0.47 mm trashësi) në shtresën e parë të llaçit të freskët, duke shmangur formimin e zbrazëtisë tek shtresa.

Sikalastic®-152 nuk mund të lëmohet me mallë të dhembëzuar ose me sfungjer. Është e mundur të lëmohet sipërfaqja, sapo maturimi i produktit është përfunduar me abrazion të lehtë.

Aplikimi me furçë:

Aplikoni shtresën e parë me furçë, sapo shtresa e parë të jetë ngurtësuar, aplikoni të dytën një herë vertikalisht dhe një herë horizontalisht, me furçë.

Në rastet e fugave të mundshme të dyshemeve dhe zonave të tjera kritike (p.sh. ndërfaqet me sipërfaqet vertikale), shtresa hidroizoluese mund të përfordohet me Sika® Seal Tape S. Duhet të vendoset mbi shtresën e parë të freskët dhe pastaj të mbulohet me shtresën e dytë. Në rast fugash që janë subjekt i zhvendosjeve të mëdha, përdorimi i Sikadur® Combiflex®-SG i detyrueshëm.

Aplikimi i pllakave qeramike mbi Sikalastic®-152:

Pllakat qeramike dhe pllakat mozaik të qelqëzuara mund të aplikohen mbi Sikalastic®-152 duke përdorur një kollë të përshtatshme pllakash (p.sh. kollë pllakash me bazë çimentoje në përputhje me kategorinë C2 sipas EN 12004 – kollë çimentoje me elasticitet mesatar). Fugat e pllakave duhet të mbushen me bojakun përkatës SikaCeram®.

Koha e punueshmërise

~ 1 orë në +20°C

Mirëmbajtja e mjeteve

Heqja e mbetjeve të freskëta nga mjetet dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / maturuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Koha e pritjes / Mbishtresa

Zhytja:

Sikalastic®-152 duhet të ngurtësohet në mënyrën e duhur përpara veshjes me mbishtresë ose kontaktit me ujë. Mund të përdoren sa për udhëzim kohët e mëposhtme të pritjes:

	+20°C	+10°C
Vendosje pllakash mbi sipërfaqe horizontale	~ 2 ditë	~ 7 ditë
Vendosje pllakash mbi sipërfaqe vertikale	~ 2 ditë	~ 3 ditë
Lyerje me emulsion	~ 2 ditë	~ 3 ditë
Zhytja në ujë	~ 2 ditë	~ 7 ditë

Kohët e pritjes mund të variojnë sipas lagështisë së mjedisit dhe nënshtresës.

Shënime mbi aplikimin / Kufizime	<ul style="list-style-type: none"> - Sikalastic®-152 nuk mund të lëmohet me mallë të sheshtë ose mallë sfungjer. - Mbrojeni nga shiu të paktën 24 - 48 orë pas aplikimit. Shmangni aplikimin dhe mbron materialin e freskët nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe/ose era e fortë. - Shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë me ujin e kloruar të pishinave me anë të shtrimit të pllakave. - Procesi i ngurtësimit është më i ngadaltë kur niveli i lagështisë së ambientit është më i lartë, p.sh. në dhoma të mbyllura ose me pamjaftueshmëri ajrosjeje dhe bodrume. Rekomandohen metoda ajrosjeje. - Në rastet e bojërave me bazë tretësi, kryeni gjithmonë teste paraprake që të siguroheni se tretësit nuk do të ndikojnë mbi shtresat e hidroizolimit. - Sikalastic-152 nuk është barrierë kundër avujve dhe mund të transmetojë tensionet e avujve në mbishtresat e aplikuara. - Në rast aplikimi në kushte temperaturash të larta, pritet të nevojitet lagia e lehtë e nënshtresës. - Sikalastic®-152 nuk është i përshtatshëm për qarkullim automjetesh. Qarkullimi i këmbësorëve lejohet vetëm nëse ka mbrojtje me pllaka.
---	--

Baza e vlerave të matshme	Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.
----------------------------------	--

Kufizime lokale	Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për përshkrimin e saktë të fushave të aplikimit.
------------------------	---

Informacione mbi shëndetin dhe sigurinë	Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit të sigurt, maganizimit dhe asgjësimit të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen botimit më të fundit të fletës me të dhënat e sigurisë (Safety Data Sheet, SDS), e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike, etj. rreth sigurisë gjatë përdorimit të produktit.
--	---

Shënime ligjore	Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të SIKA-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e SIKA-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj formë tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. SIKA ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas të gjitha kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit.
------------------------	---



Sika Albania SHPK
 Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
 Ndërtesa nr. 7, kati 4
 Tirana, Albania.

Tel.: +355 4 454 0070
 Email: info@al.sika.com
 alb.sika.com